

VIZE PER GARE SPORTIVE

Viza për Garë Sportive i lejon hyrjen, në Itali, atij personi fizik ose pjestarit të një grupi sportiv, i cili është ftuar të marrë pjesë në aktivitete apo manifestime të ndryshme me karakter sportiv.

Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për Garë Sportive duhet të paraqitet personalisht pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me gërma të mëdha shtypi.

Kërkesës për vizë duhet t'i bashkangjiten dokumentet e poshtëshënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:

1) Pasaportë ose Dokument Udhëtimi të vlefshëm deri në skadimin e afatit të vizës së kërkuar;

2) Nulla Osta ose Vërtetim me shkrim i CONI-t (Comitato Olimpico Nazionale) ose i Federatës Sportive Italiane që të vërtetojë pjesëmarrjen e të interesuarit në aktivitetin sportiv si edhe të kërkojë lëshimin e vizës hyrëse;

3) Ftesë nga Klubi Sportiv Italian ku të përfshihet edhe programi përkatës i eventit sportiv;

4) Vërtetim me shkrim i lëshuar nga Federata përkatëse e Kosovës ku të vërtetohet që klubi sportiv i ftuar është anëtar i Federatës;

5) Vërtetim me shkrim i lëshuar nga klubi sportiv përkatës ku të vërtetohet kualifikimi dhe anëtarësia e sportistit/ve të ftuar;

6) Dokumente që vërtetojnë mbulimin e shpenzimeve financiare të qëndrimit në Itali (nëse nuk bien në ngarkim të Entit ftues në Itali);

7) Dokumente që vërtetojnë vendqëndrimin në Itali: rezervimi hotelier ose Deklarata e Mikpritjes (Dichiarazione di ospitalita') e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i Entit ftues në Itali dhe e shoqëruar nga një fotokopje e qartë e letërnjoftimit të tij;

8) Dokumente që vërtetojnë situatën sociale dhe profesionale në Kosovë:

- **për punëtorët me kontratë:** kontrata e punës, vërtetim i punëdhënësit ku të tregohen qartë: data e fillimit të marrëdhënies së punës, kualifikimi profesional dhe rroga mujore si edhe një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore ku të vërtetohet derdhja e kontributeve pensionale dhe të tatimit mbi paga;

- **për personat që kanë biznesin e tyre personal:** certifikata e rregjistrimit të firmës si edhe një vërtetim mbi biznesin, me datë jo më të hershme se një muaj, i lëshuar nga Autoriteti i Rregjistrimit të Bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ku të vërtetohet lloji i aktivitetit tregtar;

- **për studentët:** vërtetim rregjistrimi i lëshuar nga shkolla ose Fakulteti, kontratat e punës së prindërve, vërtetim i punëdhënësit të këtyre të fundit ku të tregohen qartë: data e fillimit të marrëdhënies së punës, kualifikimi profesional dhe rroga mujore si edhe një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore ku të vërtetohet derdhja e kontributeve pensionale dhe të tatimit mbi paga;

- **për pensionistët:** vërtetim mbi marrjen e pensioneve;

- **për të papunët:** vërtetim mbi papunësinë i lëshuar nga Qendra për Punë Sociale pranë Komunës së vendbanimit.

9) Dokumente që vërtetojnë situatën ekonomike dhe financiare në Kosovë:

- vërtetime mbi pasuri të patundshme në Kosovë;
- pasqyrë përmbledhëse bankare ORIGJINALE (jo e fotokopjuar ose e skanerizuar) e llogarisë Tuaj (personale/ familjare/e biznesit) e lëshuar nga banka përkatëse në datë jo më të hershme se një vit;
- fotokopje të debi ose kredi kartelave bankare (duhet të fotokopjohet vetëm pjesa e përparme).

10) Dokumente që vërtetojnë mjetet e transportit: bileta e avionit vajtje/ardhje,

nëse udhëtoni me makinë, fotokopje e qartë e dokumenteve të automjetit; nëse udhëtoni me autobus të organizuar, përveç dokumenteve të qarkullimit të autobusit duhet të paraqitet edhe kontrata e transportit;

11) Dokumente që vërtetojnë qëndrime të mëhershme në hapësirën territoriale Schengen: fotokopje e vizave Schengen;

12) Sigurim shëndetësor ndërkombëtar i njohur nga Ambasada Italiane në Prishtinë;

polica e sigurimit shëndetësor duhet të jetë e nënshkruar pranë njërit prej Kompanive vijuese të Sigurimit: **ADAC-VERSICHERUNGEN, ELSIG, ILLYRIA, KOSOVA E RE, SIGAL, SIGKOS, SIGMA e SIGURIA**; ajo duhet të jetë e vlefshme në të gjithë hapësirën territoriale të shteteve Schengen, duhet të mbulojë shpenzimet spitalore në rast sëmundjeje dhe/ose aksidenti si edhe shpenzimet e nevojshme për riatdhesimin e kufomës në rast vdekjeje. Shuma sigurorese minimale nuk duhet të jetë më e vogël se 30.000 Euro

Kujdes: Renditja e Kompanive të Sigurimit të sipërshënuara është bërë në rend alfabetik dhe nuk shpreh, në asnjë mënyrë, asnjë preferencë zjedhjeje nga ana e Sektorit të Vizave pranë kësaj Ambasade.

12) VETEM PER TE MITURIT NEN 18 VJEC:

- **çertifikatë lindjeje e të miturit** e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes CivileMinistria e Punëve të Brendshme, Prishtinë;
- **pëlqimi i prindit/prindërve** për të dalë jashtë Kosovës e cila jepet përpara zyrtarit të vizave pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë me anën e një deklarate që të dy prindërit (ose prindi që mbetet në Kosovë) duhet të nënshkruajnë personalisht përpara tij ose pranë një noteri.

AMBASADA ITALIANE PRISHTINE